



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Nr. 1309/prot.

Tiranë, më 29.5.2020

Lënda: Kthim përgjigje

Z. ARMAND SKAPI
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Bulevardi "Gjergj Fishta", Tiranë

Për dijëni: **ZNJ. VJOLLCA BRAHO**
INSPEKTORIATI SHTETËROR SHËNDETËSOR
"Rruga e Kavajës", nr. 1001, Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 3619 Prot., datë 21.05.2020, administruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) me nr. 1309 prot., datë 27.05.2020, përmes së cilës kërkonte sqarime dhe argumente mbi publikimin në platformën online për sigurinë dhe mbrojtjen e gazetarëve në kuadër të Këshillit të Evropës, datë 19 maj 2020, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Që në fillim të situatës së krijuar nga COVID-19, Autoriteti i Mediave Audiovizive, më 10 mars 2020 apeloj për kujdes në rastet e programeve të drejtpërdrejta ose me regjistrim në studio audiovizive, që kanë përqëndrim personash, për të respektuar kërkesat e disatancave optimale mes tyre. Duke vlerësuar angazhimin e redaksive audiovizive për raportimin dhe mbulimin e situatës së krijuar nga përhapja e koronavirusit, AMA u kërkoi operatorëve audiovizivë shmangien e rrethanave me studio televizive që aplikojnë formatet programore me prani të përqëndruar të publikut, si ndihmë në parandalimin e rreziqeve të përhapjes së koronavirusit nga persona potencialisht të infektuar, bazuar dhe në udhëzimet e bëra publike nga Ministria e Shëndetësisë.

Një ditë më pas, më 11 mars, Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, duke ndjekur situatën dhe përpjekjet për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, u

kujtoi subjekteve audiovizive të kujdesen me përgjegjësi maksimale për personelin që angazhojnë brenda mjediseve të redaksive e studiove të regjistrimit dhe transmetimit.

Në këtë periudhë u ndalua prania e publikut të përqëndruar në programe televizive direkte ose të regjistruara. Ndërsa në formatet informative apo forum kërkohet të mos kishte më shumë se dy persona të pranishëm, duke respektuar distancat apo standardet e përfshira edhe në udhëzimet e publikuara nga Ministria e Shëndetësisë, për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Duke vlerësuar shëndetin e qytetarit mbi gjithçka, AMA, nga data 12.03.2020 filloi monitorimin e transmetimeve audiovizive. Gjatë këtyre monitorimeve, bazuar në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në kuadër të respektimit të vendimeve dhe udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë, në kushtet e vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Shqipëri, AMA evidentoi shkelje gjatë programit “360 Gradë”, të datës 11.05.2020, program që transmetohet në televizionin “Ora News”.

Nga monitorimi i kryer rezultoi se, në studio, bashkë me moderatorin, ishin dhe katër të ftuar, prani që shkel haptazi udhëzimet e Aktit Normativ në kushtet e pandemisë, për mbrojtjen e personelit gjatë transmetimeve audiovizive.

Duke e konsideruar parësore mbrojtjen e shëndetit të stafit të angazhuar dhe bashkëpunëtorëve të subjekteve audiovizive, për të parandaluar efektet nga përhapja e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, për rastin e evidentuar, AMA, me shkresën nr. 1216 prot., datë 13.05.2020, i tërhoqi vëmendjen televizionit “Ora News”, duke i kërkuar respektimin e udhëzimeve të Aktit Normativ në kushtet e pandemisë.

Më pas, Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), dega Tiranë, më datë 14.05.2020, ka evidentuar shkelje të përsëritur nga ky subjekt audioviziv, për prezencë në studio të më shumë se dy personave, duke akorduar gjoba, bazuar në ligjin 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive”, Aktin Normativ nr. 3 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohës zgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”. Për këtë vendim, ISHSH ka njoftuar me shkresë zyrtare AMA-n më datë 15.05.2020.

Më pas, nisur nga disa informacione dhe formulime të ndryshme mediatike, mbi vendimmarrje të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor për mbyllje të subjektit “Ora News”, AMA bëri me dije se, nuk ka asnjë vendim apo qëllim për mbylljen e ndonjë televizioni.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Gentian Sala